Nr. 148/1 Prot.
Dt. 05.02.2013

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZËVENDËSKRYEMINISTRI
MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS PUBLIKE

Adresa: Blvd "Dëshmorët e Kombit", 1001 web http://www.mete.gov.al

Nr. 1774 Prot.

Tiranë, më 11.2.2013

Drejtuar: SH.P.K "ELBER"

ELBASAN

Lënda: *Miratohet statuti i shoqërisë "Elber" sh.p.k Elbasan*

Pasi shqyrtuam projekt statutin e paraqitur për miratim nga shoqëria "Elber" sh.p.k Elbasan me shkresën tuaj nr. 148, datë 04.02.2013, ky statut u riformulua ne METE ne zbatim te dispozitave te nenit 230 te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Për këto arsye bazuar ne Ligjin Nr. 8885, datë 22.04.2002, nenit 216 e ne vijim te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ortaku shtet i cili zotëron 100% te pjesëve te kapitalit te "Elber" sh.p.k Elbasan miraton statutin e ri te shoqërisë.

Ngarkohet "Elber" sh.p.k Elbasan për kryerjen e veprimeve përkatëse ne përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit" Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32, 36.

EDMOND HAXHINASTO

Aplikante: Klaudia Krasnike

STATUT I SHOQËRISË "ELBER" SH.P.K.

Duke qënë se shoqëria "ELBER" SH.P.K. Elbasan është një shoqëri e cila ushtron akivitetin e saj në përputhje të plotë me kuadrin ligjistativ në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Ligji nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", në nenin 230 paragrafi 2, parashikon detyrimin për të tëra shoqëritë tregtare, të themeluara përpara hyrjes së tij në fuqi, të përshtasin organizimin dhe funksionimin e tyre me ligjin në fjalë.

Shoqëria "ELBER" SH.P.K. është themeluar me datë 07.12.2000, pra përpara hyrjes në fuqi të ligjit të sipërpermendur, dhe si rrjedhojë i nënshtrohet detyrimit të mësipërm;

se është në interesin maksimal të shoqërisë "ELBER" SH.P.K. që të përmbushë këtë detyrim sa më parë që të jetë e mundur;

miratimi i statutit të ri të shoqërisë, do të zëvendësojë statutin aktual, që është mënyra më efikase, më e drejtë, më e saktë dhe më e plotë për ta vendosur shoqërinë "ELBER" SH.P.K. në kushtet e ligjshmërisë së plotë në raport me ligjin e sipërpërmendur:

Për sa më sipër ortaku i vetëm i shoqërisë, miraton statutin e ri të shoqërisë "ELBER" SH.P.K. me përmbajtjen si vijon:

TË PËRGJITHSHME

Në këtë statut:

- "Ligj" është ligji nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.
- "Statut" është ky statut i shoqërisë;
- "Kuota" janë njësitë bazë të ndarjes së kapitalit të shoqërisë, të cilat u japin zotëruesve të tyre tagër për të ushtruar në Asamblenë e Përgjithshme, të drejtat e ortakut dhe për të përfituar pjesë të fitimeve dhe të shpërndarjes së pasurive të mbetura pas likuidimit, në raport të drejtë me pjesën e kapitalit që kuotat e tyre përfaqësojnë.
- "Ortakë" janë personat fizikë apo juridikë, emrat e të cilëve janë regjistruar në regjistrin e ortakëve të shoqërisë si zotëruesë të kuotave.

Aplikante: Klaudia Krasnika

- "Ditë të plota" në lidhje me periudhën e njoftimit është periudha që nuk e përfshin ditën kur është dhe/ose kur konsiderohet se është dhënë njoftimi dhe ditën për të cilën është dhënë ose hyn në fuqi njoftimi.

KREU I
THEMELIMI, EMËRTIMI, REGJISTRIMI DHE PERSONALITETI JURIDIK
NENI 1
DATA E THEMELIMIT, EMËRTIMI

(1) Shoqëria "ELBER" SH.P.K. është themeluar me datë 07.12.2000.
(2) Shoqëria "ELBER" SH.P.K. është regjistruar pranë regjistrit tregtar me vendim nr.24764, me datë 07.12.2000 të Gjykatës së rrethit Tiranë.
(3) Kjo shoqëri ushtron aktivitetin e saj me NIPT K13621201W.
(4) Ky statut i shoqërisë nuk shuan dhe as ndryshon statusin, të drejtat dhe/ose detyrimet e shoqërisë të themeluar dhe regjistruar si më lart.
(5) Ky statut nuk krijon një shoqëri të re të drejtës, nuk ndryshon marrëdheniet me të cilat shoqëria "ELBER" SH.P.K. është tashmë palë dhe në çdo rast nuk ndikon në debitë dhe/ose kreditë e shoqërisë "ELBER" SH.P.K.
(6) Ky statut miratohet me qëllim përshtatjen e organizimit dhe funksionimit të shoqërisë "ELBER" SH.P.K. me ligjin tregtar.

NENI 2
PERSONALITETI JURIDIK

(1) Shoqëria është person juridik shqiptar. Shoqëria "ELBER" sh.p.k. është person juridik publik, jo-buxhetor shqiptar që ka formën ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar sipas ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.
(2) Shoqëria gëzon të drejtat, si person juridik shqiptar që prej datës në të cilën është themeluar dhe regjistruar në regjistrin tregtar, pa i kushtëzuar këto të drejta nga miratimi i këtij statuti.
(3) Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara në dokumentet themeluese (Akt-Themelimi dhe Statut).

NENI 3
EMRI I SHOQËRISË

(1) Shoqëria emërtohet "ELBER" sh.p.k.. Emërtimi i shoqërisë shkruhet vetëm me shkronja të mëdha. Në dokumentat, faturat, reklamat dhe botimet e nxjerra

Aplikante: Klaudia Krasnika

---

nga shoqëria, emri i saj do të ndiqet nga inicialet sh.p.k., nga numri i regjistrimit [illegible]
(2) Shoqëria e ushtron veprimtarinë në emrin e saj sipas paragrafit 1 të këtij neni.
(3) Ndryshimi i emërtimit të shoqërisë, bëhet nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë.

NENI 4
FORMA

(1) Shoqëria është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.
(2) Shoqëria mund ta ndryshojë formën e saj nëpërmjet procedurës së shndërrimit.

NENI 5
OBJEKTI

1. Objekti i shoqërisë është:
a) Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij;
b) Mirëmbajtjen e sistemit(eve) të furnizimit me ujë të pijshëm;
c) Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve;
d) Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura dhe shitja e tij;
e) Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre.
2. Shoqëria mundet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda limiteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.
3. Shoqëria do të kryejë çdo veprimtari [illegible] me qëllim marrjen e lejeve, autorizimeve, licensave dhe miratimeve të nevojshme për realizimin e veprimtarive të saj, për të cilat kërkohen këto dokumente administrative.

NENI 6
KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë është pa afat të caktuar. Ky afat mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Aplikante: Klaudia Krasnika

NENI 7
SELIA

1. Selia e shoqërisë është në Elbasan, lagja Dyli Haxhire Myzyri, ish. N.B.SH. Kopling. Shoqëria sipas parashikimeve të këtij statuti dhe legjislacionit në fuqi, mund të hapë si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, qendra dhe përfaqësi apo filiale, degë dhe shoqëri të tjera, me vendim të ortakut.
2. Adresa e faqes së internetit së shoqërisë është www.elber.al.
3. Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është info@elber.al.

KREU II
KAPITALI THEMELTAR DHE KUOTAT
NENI 8
KAPITALI THEMELTAR

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 83.000.000 Lekë, i përbërë nga 83.000 kuota me vlerë nominale 1.000 (njëmijë) lekë secila. Kapitali i shoqërisë është derdhur dhe nënshkruar tërësisht.
2. Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga para, pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme dhe të drejta.
3. Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme.
4. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

NENI 9
KUOTAT, MËNYRAT E PAGIMIT DHE TË FITIMIT DHE KALIMIT TË KUOTAVE

1. Kuotat zotërohen në masën 100% nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si përfaqësuese e pronarit shtet.
2. Kuotat e kapitalit e të drejtat e lindura prej tyre mund t'i kalojnë ortakëve apo të tretëve nëpërmjet :
a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
b) Shitjes;
c) Trashëgimisë;
d) Dhurimit;
e) Çdo mënyre tjetër të parashikuar në ligj.

Aplikante: Klaudia Krasnika

---

3. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kuotat duhet të bëhen me shkrim.
4. Në rast shitjeje të kuotave ortakët e shoqërisë kanë të drejtë e parablerjes para të tretëve.
5. Pronësia dhe titulli mbi kuotat do të rezultojë nga regjistrimi i emrit të pronarit në *Librin e Ortakut*, që do të mbahet në selinë e shoqërisë, nën kujdesin e Administratorit.
6. Libri i Ortakut do të përmbajë informacionin e mëposhtëm :
- Numrin e kuotave të mbajtura nga Ortaku;
- Datën në të cilën Ortaku fitoi pronësinë;
- Emrin dhe adresën e Ortakut;
- Vlerën nominale të kuotave të mbajtura;
- Detaje për çdo peng apo barrësim mbi kuotat.
7. Ortaku ka të drejtë të verifikojë regjistrimin e tij në Librin e Ortakut dhe Administratori, në qoftë se është kërkuar me shkrim, do t'i sigurojë ndihmën e domosdoshme për këtë një.

KREU III
ORGANET DREJTUESE
NENI 10
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

1. Asambleja e Përgjithshme është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
2. Asambleja e Përgjithshme është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë, që miraton [illegible] Statutit [illegible]
3. Asambleja e Përgjithshme shprehet me vendim për të gjitha çështjet e përcaktuara në *nenin 81 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar*.
4. Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër ose nga një person i tretë.
5. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.
6. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme e cila përfshin dhe mbledhjet me të njëjtin rend dite.

Aplikante: Klaudia Krasnika

NENI 11
MËNYRA E THIRRJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

1. Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme bëhet nëpërmjet njoftimit me letër rekomande në adresën e çdo aksionari, me shpenzimet e vetë shoqërisë. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më pak se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë.
2. Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.
3. Për sa kohë interesi i shoqërisë e kërkon [illegible] zotërohet nga një ortak të vetëm, ky ortak mund të bjerë dakord që të marrë vendime me shkrim pa thirrur mbledhjen e ortakëve dhe duke mos e respektuar pikën 1 të këtij neni. Vendime të tilla mund të merren dhe jashtë Republikës së Shqipërisë dhe [illegible] t'i komunikohet Administratorit, i cili do t'i regjistrojë ato në librin e vendimeve të Ortakut të shoqërisë, që do të mbahet në selinë e shoqërisë.

NENI 12
KUORUMI

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 % të kuotave.
2. Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas *nenit 87 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar*, ajo mund të marrë vendime të vlefshme nëse ortakët që zotërojnë [illegible] personalisht dhe votojnë me [illegible] gjysmën e numrit të votave, janë të pranishëm.
3. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 13
MARRJA E VENDIMEVE

1. Asambleja e Përgjithshme vendos *me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës*, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
2. Asambleja e Përgjithshme vendos *me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës* për të gjitha çështjet e tjera të përcaktuara në nenin 81 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.
3. Çdo ndryshim statuti depozitohet në QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.
4. Të gjithë vendimet e marra në mbledhje duhet të regjistrohen në procesverbale sipas parashikimit të *nenit 90 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar*.

NENI 14
PËRJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTËS

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme merr vendim për:
a) Vlerësimin e veprimtarisë së tij;
b) Shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
c) Ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
d) Dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

NENI 15
ADMINISTRIMI

1. Asambleja e Përgjithshme emëron një person fizik si Administrator.
2. Shoqëria administrohet nga një Administrator.
3. Administratori zgjidhet për një afat 3 vjeçar, me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i Administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
4. Administratori zgjidhet me kombësi shqiptare, nuk mund të ushtrojë veprimtarinë në më shumë se një shoqëri dhe nuk mund të jetë mbi moshën 65 vjeç. Administratori mund të zgjidhet nga të punësuarit e rangut të lartë të shoqërisë, por edhe jashtë saj.
5. Emërimi dhe shpërblimi i Administratorit përcaktohet me vendim të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme, në aktin e emërimit.
6. Në rast vdekje, dorëheqje, pezullimi, pushimi të çdo Administratori, pasardhësi që zë vendin e tij zgjidhet menjëherë nga Asambleja e Përgjithshme me vendim të zakonshëm.

Aplikante: Klaudia Krasnika

---

7. Mbas pranimit të emërimit të tyre, Administratori pranon me shkrim që marrëdhënia e tij me shoqërinë është e lidhur me bazë besimi dhe në lidhje me këtë vendim për t'i pushuar nga puna ata me anë të një vendimi, gjykohet si arsye legjitime dhe nuk kundërshtohet.

NENI 16
KOMPETENCAT E ADMINISTRATORËVE

1. Administratori i përmbahet me profesionalizëm të gjithë kompetencave dhe përgjegjësive të përcaktuara në *nenet 14, 15, 17, 18, 95 – 98 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar*.
2. Administratori i propozon Asamblesë së Përgjithshme për :
a) Përcaktimin dhe ndryshimin e programit të veprimtarisë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë të shoqërisë.
b) Treguesit e performancës që duhet të arrijë shoqëria në fund të vitit fiskal, si element bazë i vlerësimit të punës së drejtorisë së shoqërisë.
c) Kryerjen e investimeve dhe financimeve për vitin financiar, si dhe masat e tjera që do të kërkonin ndryshimin e kapitalit themeltar të shoqërisë.
d) Hapjen e veprimtarive ose njësive të reja dhe ndryshimin e objektit të shoqërisë.
e) Shitjen e pasurive që përbëjnë aktivin e qëndrueshëm të shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi.
f) Krijimin e shoqërive të reja dhe pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërive të tjera.
g) Marrjen e huave afatmesme, afatgjata.
h) Strukturën e organizimit të shoqërisë.
i) Si dhe për çdo çështje tjetër që [illegible] në bazë të ligjit "Për shoqëritë tregtare", [illegible]
3. Administratori ka kompetenca të plota për të vepruar në emër të shoqërisë.
4. Në marrëdhëniet me të tretët, shoqëria merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga aktet e nënshkruara nga Administratori edhe kur këto akte e tejkalojnë objektin e veprimtarisë së shoqërisë, përveç rastit kur shoqëria provon se të tretët e dinin që akti i Administratorit kapërcen objektin e veprimtarisë së Shoqërisë dhe vepronte me keqbesim, ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt, duke pasur parasysh faktin se shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme. Klauzolat e statutit që kufizojnë kompetencat e Administratorit duhet të respektohen nga të tretët. Kompetencat e Administratorit që përfaqëson shoqërinë do të përfshijnë për këtë qëllim kompetencën që të nënshkruaj çeqe, urdhra, kontrata, nota zyrtare, drafte dhe dokumenta e instrumenta të tjerë në lidhje me aktivitetin e shoqërisë dhe të ekzekutojë çdo dokument që kërkon vulën e shoqërisë me përjashtim kur ekzekutimi i këtij dokumenti kërkohet ose lejohet ndryshe nga ligji të nënshkruhet

Aplikante: Klaudia Krasnika

---

ose të ekzekutohet ose [illegible] kur nënshkrimi dhe ekzekutimi i tij do të delegohet qëllimisht me vendim të Asamblesë me vendim të zakonshëm të një zyrtar [illegible]
5. Aktet, me të cilat shoqëria merr përsipër detyrimet ndaj të tretëve, duhet të nënshkruhen nga Administratori ose personi i autorizuar rregullisht nga ky i fundit për këto akte.
6. Administratori i shoqërisë harton strukturën e shoqërisë, të cilën e miraton në Asamblenë e Përgjithshme.
7. Marrëdhëniet brenda shoqërisë përcaktohen me rregullore, të cilat miratohen nga Administratori i shoqërisë. Sa i përket Rregullores së Përgjithshme të funksionimit të shoqërisë, [illegible] Administratori i shoqërisë i cili kujdeset që ajo të jetë në përputhje me strukturën e shoqërisë të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e miratimit. Për këtë qëllim Administratori është i detyruar që të paraqesë një kopje të njehsuar me origjinalin të kësaj Rregulloreje në Asamblenë e Përgjithshme, në ditën e fiqizimit të saj, brenda 20 ditëve nga data e marrjes në dorëzim Asambleja ka mundësi të kundërshtojë hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, duke sugjeruar ndryshimet e duhura. Në rast të kundërt [illegible] nga Asambleja. Sa i përket rregulloreve të tjera të organizimit të brendshëm të shoqërisë, nuk behet paraqitja e tyre para Asamblesë së Përgjithshme, por ato miratohen drejtpërdrejtë nga Administratori.

KREU IV
VITI FINANCIAR, EKSPERTËT, PËRCAKTIMI I FITIMIT
NENI 17
VITI FINANCIAR

Viti financiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor.

NENI 18
LLOGARITË FINANCIARE DHE EKSPERTËT

1. Administratori do të mbajë llogari adekuate dhe do të përgatisë raporte financiare për të reflektuar me kujdes kushtet financiare të shoqërisë në përputhje me parimet e kontabilitetit. Llogaritë e raporteve financiare do të jenë në formë e me detaje dhe në përputhje me standartet e kontabilitetit sipas legjislacionit në fuqi.
2. Asambleja e Përgjithshme me vendim të zakonshëm emëron një ose më shumë ekspertë kontabël të jashtëm, të cilët do të kenë këto përgjegjësi :
- Kontrollon të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të

Aplikante: Klaudia Krasnika

---

ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.
- Në përfundim të kontrollit ekspertët kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të llogarisë financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat i është e detyruar që t'ia paraqesë Asamblesë së Përgjithshme për ta shqyrtuar e miratuar mbi bazën e së drejtës vendimore që ka.
- Informon me shkrim Administratorin dhe Asamblenë e Përgjithshme mbi çdo parregullsi ose mangësi të vërejtur gjatë operacioneve, transaksioneve, procedurave, regjistrimeve ose llogarive financiare të shoqërisë, që mund të rezultojnë në humbje materiale për shoqërinë.
- Të rishikojë përshtatshmërinë e auditimeve dhe praktivave e procedurave të përmirësimit e tyre;
- Të kryejë të gjithë detyrat e përcaktuara në *ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar*.

NENI 19
REZULTATI I USHTRIMIT DHE PËRCAKTIMI I FITIMIT

1. Rezultati i veprimtarisë përcaktohet nga diferenca ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve.
2. Nga fitimet e ushtrimit, pasi të jenë zbritur, kur është rasti humbjet e mëparshme, hiqet të paktën 5 (pesë) % për të krijuar fondet e rezervës së domosdoshme. Kur kjo rezervë arrin 1/10 (një të dhjetën) e kapitalit themeltar nuk bëhet më heqje nga fitimet e ushtrimit.
3. Ajo (heqja) rifillon, kur për arsye të çfarëdoshme, rezerva e domosdoshme ka zbritur nën 1/10 (një të dhjetën) e kapitalit themeltar.
4. Përdorimi i fitimit bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

KREU V
PRISHJA, RIORGANIZIMI I SHOQËRISË
NENI 20
PRISHJA DHE LIKUIDIMI

1. Shpërndarja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :
a) Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, sipas përcaktimit të nenit 10/1 të këtij Statuti;
b) Me hapjen e procedurave të falimentimit;

Aplikante: Klaudia Krasnika

---

c) Nëse nuk kryhet veprimtari tregtare për 2 vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
d) Me vendim të gjykatës.
2. Në këtë rast ortakët marrin vendim me shkrim për të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 ose disa likuidatorë duke shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

NENI 21
RIORGANIZIMI I SHOQËRISË, BASHKIMI – NDARJA

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në *ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"*, i ndryshuar.

KREU VI
TË NDRYSHME
NENI 22
BAZA LIGJORE

1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Statut dhe me të gjithë dispozitat e legjislacionit shqiptar.
2. Për sa nuk parashikohet në këtë Statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit *"Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar*, dhe çdo ligj specifik në Republikën e Shqipërisë.

ORTAKU I SHOQËRISË
"ELBER" SH.P.K.
MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS

EDMOND HAXHINASTO

Aplikante: Klaudia Krasnika

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr 24764 rregj.

24764

VENDIM

I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me daten 7.12. 2000, ne Gjykaten e Rrethit Tirane, une Gjyqtarja E. Bog mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga Shoqeria "Elber" Sh.p.k, e perfaqesuar nga Z. Besnik Bocaj, Perfaqesues i Shoqerise sipas autorizimit dhene me date 23 Tetor 2000, per rregjistrimin e saj si person juridik ne Rregjistrin Tregtar dhe:

KONSTATOVA:

Kerkuesi i siperpermendur eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e themeluar ne baze te kontrates se themelimit dhe statutit te shoqerise hartuar me — 2000, dhe depozituar ne gjykate me:

- **Emertim**: "Elber" Sh.p.k.

- **Qender**: Ndermarrja e Ujesjelles Kanalizimeve e Qytetit Elbasan, Lagjia Kala, Elbasan, Shqiperi.

- **Kapitali themeltar**: 100.000 Lek (kontribut ne para), i ndare ne kuota me vlere nominale 1000 Lek secila.

- **Kohezgjatje e shoqerise**: Per nje periudhe kohe te pakufizuar.

- **Ortak**: ***Berlinwasser International GmbH*** me qender ne Stralauer Straβe 32, 10719, Berlin Republika Federale e Gjermanise;

- **Administrator i pare**: Z. Wilhelm Feitsma.

- **Objekt aktiviteti**: Objekti i Shoqerise eshte venia ne perdorim e sherbimeve te ujit dhe ujrave te zeza ne Republiken e Shqiperise dhe ne zonat fqinje, dhe kryerja e te gjitha aktiviteteve vartese qe lidhen me to dhe aktiviteteve te tilla te cilat bashkarisht jane ndermarre nga drejtuesit e ujit dhe ujrave te zeza ose te cilat mund te nxisin direkt ose indirekt objektin e Shoqerise ne Republiken e Shqiperise dhe ne zonat fqinje.

Gjithashtu, ne perputhje me legjislacionin Shqiptar, Shoqeria mund te zhvilloje cdo aktivitet rrjedhes ose te lidhur ne menyre direkte apo indirekte me objektivat e rradhitura me lart. Per te arritur qellimin e mesiperm, Shoqeria mund te kryeje transaksione qe kane te bejne me pasuri te luajtshme apo te paluajtshme si dhe cdo aktivitet tjeter tregtar, financiar, qiraje apo hipotekor qe mund te konsiderohet i dobishem ose i nevojshem per arritjen e objektit te Shoqerise.

PER KETO ARSYE

Si gjyqtare e vetme ne baze te Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregtare " dhe Ligjit Nr. 7667 date 28.01.1993 " Per Rregjistrin Tregtar "

VENDOSA

- Pranimin e kerkeses se mesiperme per rregjistrimin e Shoqerise "Elber" Sh.p.k si person juridik me:

- **Emertim**: "Elber" Sh.p.k.

- **Qender**: Ndermarrja e Ujesjelles Kanalizimeve e Qytetit Elbasan, Lagjia Kala, Elbasan, Shqiperi.

- **Kapitali themeltar**: 100.000 Lek (kontribut ne para), i ndare ne kuota me vlere nominale 1000 Lek secila.

- **Kohezgjatje e shoqerise**: Per nje periudhe kohe te pakufizuar.

- **Ortak**: ***Berlinwasser International GmbH*** me qender ne Stralauer Straβe 32, 10719, Berlin Republika Federale e Gjermanise;

- **Administrator i pare**: Z. Wilhelm Feitsma.

- **Objekt aktiviteti**: Objekti i Shoqerise eshte venia ne perdorim e sherbimeve te ujit dhe ujrave te zeza ne Republiken e Shqiperise dhe ne zonat fqinje, dhe kryerja e te gjitha aktiviteteve vartese qe lidhen me to dhe aktiviteteve te tilla te cilat bashkarisht jane ndermarre nga drejtuesit e ujit dhe ujrave te zeza ose te cilat mund te nxisin direkt ose indirekt objektin e Shoqerise ne Republiken e Shqiperise dhe ne zonat fqinje.

Gjithashtu, ne perputhje me legjislacionin Shqiptar, Shoqeria mund te zhvilloje cdo aktivitet rrjedhes ose te lidhur ne menyre direkte apo indirekte me objektivat e rradhitura me lart. Per te arritur qellimin e mesiperm, Shoqeria mund te kryeje transaksione qe kane te bejne me pasuri te luajtshme apo te paluajtshme si dhe cdo aktivitet tjeter tregtar, financiar, qiraje apo hipotekor qe mund te konsiderohet i dobishem ose i nevojshem per arritjen e objektit te Shoqerise.

U shpall sot me daten 4. 12. 2000

GJYQTARE